



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 57/2023**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci kryesues, Hajriz Hoti dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rr. J, të paraqitur ndaj Vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot. 01/1062-2023 të datës 18.10.2023, lidhur me procedurën e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2023, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET poshtë e palejuar ankesa** e ankuesit Rr. J, e parashtruar kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot. 01/1062-2023 të datës 18.10.2023, lidhur me procedurën e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime.

## **A r s y e t i m**

Me datën 20.10.2023, PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitur nga Rr. J, të paraqitur ndaj Vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot. 01/1062-2023 të datës 18.10.2023 me të cilën pretendon se duke u bazuar në Ligji nr. 08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 119, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me procedurat e fundit të Kuvendit Komunal në Shtime për dorëheqjen dhe zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Shtime nga ana e KQZ-së, ku Komuna e Shtimes, përkatësisht zyrtari, bashkëpunëtori profesional i Kuvendit, I. R, me datë 10.10.2023, Nr. 09/1/1045/2023 ka dërguar shkresë në KQZ për të kërkuar zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit, duke tejkalluar kompetencat e tij zyrtare dhe ka parashtruar kërkesë për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit në mënyrë të paautorizuar dhe të kundërligjshme duke cenuar kompetencat e Kryesuesit të Kuvendit dhe në kundërshtim me legjislacionit në fuqi.

Parashtruesi i ankesës thekson se personi zyrtar, I. R, ka dërguar shkresën me 13.10.2023 me numër protokollit 01/364, ndërsa në pikën e 3-të të kësaj shkrese konstaton se për shkak të mos konfirmimit të opinionit ligjor të MAPL-së “në aspektin ligjor tani nuk kemi kryesues të Kuvendit” dhe i njëjti thirret në praktikën administrative që të nënshkruaj në vend të kryesuesit të Kuvendit.

Me tej sipas parashtruesit të ankesës Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 09 tetor 2023, ka marrë Vendim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes ku në këtë mbledhje, unë Rr. J, jam zgjedhur si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes, vendim ky, i cili edhe në rastet kur niveli qendror në këtë rast MAPL mund të konsiderojë që vendimet e Kuvendit Komunal nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjet, të njëjtit në rrethanat e rastit konkret, do të mund të kërkonin nga

Komuna e Shtimes që të rishqyrtojë vendimet e saj, duke theksuar "arsyet e supozuara të shkeljes së kushtetutës apo ligjit" duhet pasur parasysh se nuk mund të suspendojë ekzekutimin e vendimeve komunale (shih nenin 82.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale).

Parashtruesi i ankesës me tej thekson se me datë 18.10.2023, Komisioni i Zgjedhjeve, ka marrë Vendim në kundërshtim me Ligjet në fuqi duke mbajtur mbledhje të kundërligjshme, të thirrur pa rend dite dhe duke votuar nëpërmjet e-mailit, pa shqyrtuar dhe dëgjuar faktet e lartpërmendura dhe kanë bërë zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit në mënyrë të kundërligjshme. Vendimi është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse i njëjti nuk përmban këshillën juridike, pra në cilin organ ka të drejtë paditësi që ta atakojë vendimin e tillë, si dhe afatin ligjor brenda të cilit ka të drejtë ta atakojë. I njëjti kërkon nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia të shqyrtojë situatën në fjalë dhe të konfirmojë se procedurat nuk janë ndjekur me përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, përkatësisht *nenin 82.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale*; par. 2 të nenit 10 (Zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës) të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës; të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal.

Gjithashtu, kërkon që mos të aprovohet kërkesa për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit në mënyrë të paautorizuar dhe të pritët deri në njoftimin zyrtar nga Kryesuesi i Kuvendit në Shtime për të pasur një proces të rregullt dhe ligjor.

Në përgjigjen në ankesë KQZ, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se kryesuesi i kuvendit komunal në Shtime deri në votimin e zëvendësimit nuk ishte konfirmuar nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal dhe në vendimin për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit Komunal në Shtime pika IV e vendimit thotë se vendimi hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimin në ueb faqen e komunës së Shtimes. KQZ më tej në përgjigjen e saj thekson se pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të lëndës në pajtim me autorizimet e dhëna të LZL-së dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal si dhe Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese KI 45/2020 dhe KI 46/2020 me datën 18.10.2023 ka nxjerr vendim ashtu që A, L, emërohet anëtari Kuvendit Komunal në Shtime nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal A, R.

Paneli, pasi që vlerësoj lejueshmërinë e ankesës se parashtruar nga pala dhe konstatoj se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Ankuesi Rr, J, ka paraqitur ankesë ndaj Vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.prot. 01/1062-2023 të datës 18.10.2023, lidhur me procedurën e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit të KQZ-së, lidhur me procedurën e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit Komunal në Shtime, duke kërkuar që të mos të aprovohet kërkesa për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit, në mënyrë të paautorizuar dhe të pritët deri në njoftimin zyrtar nga Kryesuesi i Kuvendit në Shtime për të pasur një proces të rregullt dhe ligjor.

Në dispozitat ligjore në Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së përcakton se: *PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj, në nenet 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe neni 105.1*

Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, konkretisht procedurat se kush e inicion procedurën e zëvendësimit, e anëtarit të Kuvendit Komunal, andaj rasti lëndor dhe procedura e zhvilluar, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Andaj, nisur të gjitha arsyet e paraqitura si më sipër, në pajtim me dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2022 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave dhe Apeleve, si dhe neni 119 paragrafi 3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 57/2023 më datën 24.10.2023

**Kryesues i Panelit**

Adnan Konushevci

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*